



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME-
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Zyra e Kryetarit të Komunës
Kancelarija Predsednika Opštine/ Mayor's Office

Data/Datum/Date:	23.04.2025
Nr./Br./No:	02/ 447
Për/Za/To:	Kuvendi Komunal - Shtime
Nga/Od/From:	Kryetarit të Komunës, z. Qemajl Aliu
Lënda/Predmet/Subject :	Propozim- Vendim për ndryshimin e Vendimit Paraprak për dhënien në shfrytëzim pronat Komunale Z.K Shtime

Propozim- Vendim për ndryshimin e Vendimit Paraprak për dhënien në shfrytëzim pronat Komunale Z.K Shtime Npi-01/25 dt.27.01.2025, sipas Vendimit të MAPL-së – Nr. 020-54/8-2025, datë 26.02.2025.

Në bazë të neni 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040; Statutit të Komunës së Shtimes, neni 53; Në bazë të Konfirmimit nga MAPL-së Nr.020-54/8-2025 dt.26.02.2025; Pika 2 e Vendimit Npi-01/25, datë 27.01.2025: parcela kad. nr. P-72809093-02295-30 hiqet nga propozimi pasi që e njëjta nuk është në listën e pronave komunale për dhënje në shfrytëzim për vitin 2025.

Arsyetim: Sipas Vendimit të MAPL-së Nr. 020-54/8-2025 dt.26.02.2025 paluajtshmëria me nr të parcelës P-72809093-02295-30 nuk mundë të zhvillohen procedurat për dhënje në shfrytëzim pasi që nuk është në listën e pronave për dhënje në shfrytëzim për vitin 2025.


Paluajtshmëria me nr P-72809093-02295-30 ka qenë pjesë përbërëse e parcelës kadastrale me nr P-72809093-02295-4 ku është ndërtuar edhe palestra e sporteve dhe e njëjta ka qenë në listën e pronave të cilat do të ipen në shfrytëzim por sipas detyrës zyrtare Drejtoria për Planifikim Urban, Kadastrë dhe Gjeodezi-Zyra Kadastrale Komunale ka bërë ndarje të paluajtshmërisë me qëllim të definimit të pronës për palestrën sportive dhe e cila duhet të përjashtohet nga dhënja në shfrytëzim e pronës në fjalë. Me rastin e ndarjes së paluajtshmërisë prona ka marrë numër tjetër të nën ndarjes e cila nuk rezulton në listën e dhënjes në shfrytëzim përkundër se parcela e lartëshënuar është derivat i parcelës së mëparme e cila figuron në listë për dhënje në shfrytëzim, andaj edhe propozom ndryshimin e vendimit Npi-01/25 dt.27.01.2025, sipas Vendimit të MAPL-së – Nr. 020-54/8-2025 dt.26.02.2025.

Bashkangjitur me kërkesë janë:

- Certifikata mbi pronën dhe Kopja e Planit të parcelës, e cila janë objekt i ndryshimit të Propozim - Vendimit.
- Vendimi MAPL-së – Nr. 020-54/8-2025, datë 26.02.2025.
- Vendimi paraprak për dhënje në shfrytëzim afatgjatëi pronës komunale-Zona Kadastrale Shtime Npi-01/25 dt.27.01.2025.



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-1815/25 datë:20.01.2025



Npi – 01/25 datë: 27.01.2025

Duke u bazuar në nenin 17 shkronja (a) dhe (c), dhe nenin 58 shkronja (h) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenin 4 dhe 8 të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092; Nenin 6 paragrafi 3, neni 13 dhe 14 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës; Planin Zhvillimor Komunal 2009-2020; Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/13 dt.24.01.2025; Propozimin e Zyrës së Kryetarit Nr.02/33 të datës 17.01.2025, Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e mbajtur më 27.01.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

**PARAPRAK PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË PRONËN KOMUNALE
NË ZONËN KADASTRALE - SHTIME**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në seancën e -I- të rregullt për vitin 2025, të mbajtur më 27.01.2025, me shumicën e votave miratoi Vendimin paraparak për dhënie në shfrytëzim afatgjatë pronën Komunale, si vijon:

1. Ngastra Kadastrale me numër: P-72809093-01403-0, me sipërfaqe prej: 140629m², Kultura - Kullosë e klasit të -IV- (katër). Z.K-Shtime. Pronari/Poseduesi “Komuna e Shtimes”.
2. Ngastra Kadastrale me numër: P-72809093-02295-30, me sipërfaqe prej: 81157m², Kultura – Mal i klasit të -III- (tretë). Z.K-Shtime. Pronari/Poseduesi “Komuna e Shtimes”.

II

A r s y e t i m: Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë, të pronave të paluajtshme të Komunës së Shtimes janë: Të mundësoj implementimin e Planit Zhvillimor Komunal 2009 – 2020. Përkrahjen e bizneseve vendore, Rritjen e punësimit, Rritjen e Investimeve. Rritjen e numrit të taksapaguesve, Zhvillim Ekonomik, dhe të hyra më të mëdha për Buxhetin e Komunës.

III

Procedura për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë, do të kryhet duke u bazuar në ligjet pozitive si dhe përmes konkurrencës së hapur publike.

IV

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në evidencën e protokollit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministristvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture / Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-72809093-01403-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:	632/25
Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:	23.04.2025 - 10:47
Komuna / Opština / Municipality:	SHTIME / ŠTIMLJE / SHTIME
Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:	Shime / Štimlje / Shime
Zyra Kadastrale Komune / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office:	SHTIME / ŠTIMLJE / SHTIME

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësise kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësise Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta imovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m²)	Përshkrim Opis Description	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-72809093-01403-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Drushvena Imovina / Socially owned Land		140629			

A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendi i quajtur Mesto zvano Called place	Kodi Postal Poštanski Kod Postal Code	Emri i rrugës Naziv ulice Street name	Krijuar më datën Urađeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
GËSHTENIA				

A.2 LLOJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja parcelle Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenutno koriscenje parcelle Parcel Current Use	Kualiteti i klases Kvalitet klase Quality Class	Sipërfaqja (m²) Površina (m²) Area
1	Bujqësore/Poljoprivredno/Agriculture	Kullësor/Pašnjaci/pasture	Kullësë E Klases 4/Pašnjak 4 Klase/4th Class Pasture	140629

B. PRONARI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Lienit broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postar Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojedinositi adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhurnuar Ažurirano Updated
Poseçdim individual / Individaalna Drazavina / Single possessor	Komuna e Shitimes	600258976	SHTIME / ŠTIMLJE / SHTIME /		TAHIR SINANI	1/1		




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS
MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE, PROSTORNOG PLANIRANJA I INFRASTRUKTURE
MINISTRY OF ENVIRONMENT, SPATIAL PLANNING AND INFRASTRUCTURE

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY
KOPJA E PLANIT / KOPIJA PLANA / COPY PLAN

Zyra Kadastrale Komunale/ Opštinska Katastarska Kancelarija /Municipal Cadastral Office : SHTIME
Zona Kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone: Shtime

Njësia/Jedinica/Unit	Tipi/Vrsta/Type	Sipërfaqja/Povšina/Area m ²
P-72809093-01403-0	Parcelë / Parcela / Parcel	140629



Shkalla/Razmera/Scale: 1:4191

Punoi/Obradio/Created: Kadrije Zeqa

Nënshkrimi/Potpis/Signature:

Shënim/Beleška/Note: *pen*



Data/ Data/Date: 23.04.2025

Koha/ Vreme/ Time: 10:47:53



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Qemajl Aliu, Kryetar i Komunës së Shtimes Adnan Ademi, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Shtimes	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Elbert Krasniqi, Ministër i MAPL-së Jeton Qela, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erblin Hetemi, Drejtor i Departamentit Ligjor	Data: 14.02.2025 Nr.020-54
Zyrtaret përgjegjës:	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave Sanije Dëguti, Zyrtaree Lartë për Monitorim të Komunave	
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor		
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor		
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si dhe Rregulloren nr. 06/2021 për ndryshim-plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 14/2023 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:

Vendimi Praprak Npi-01/25 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë pronën komunale në zonën kadastrale -Shtime
I miratuar më datë: 27.01.2025
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 30.01.2025

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës nuk është në pajtim me dispozitat e legjisllacionit në fuqi.

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e mbajtur me datë 27.01.2025, ka miratuar Vendimin Paraprak Npi-01/25 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë pronën komunale në zonën kadastrale -Shtime.

MAPL, konstaton se vendimi paraprak Npi-01/25 i nxjerrë nga Kuvendi i Komunës së Shtimes ka parapar dy parcala për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronës komunale. Parcela me numer P-72809093-02295-30 nuk është e publikuar në listën e pronave të cilat janë planifikuar për dhënie në shfrytëzim ashtu siq parashifet me nenin 13 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe në nenin 6 të Rregullores (QRK) - Nr.09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Për pronën me numër P-72809093-02295-30 nuk mund të zhvillohen procedurat për dhënie në shfrytëzim.

Andaj bazuar në të lartcekurat, Kuvendi i Komunës së Shtimes, duhet të ndërmer veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin më legjislationin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbete në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm lidhur me këtë vlerësim.